



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 41/19
Prishtinë, më 21.01.2019, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hoti, Blerim Kuqi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontic.

Pjesëmarrës i ftuar: Bedri Hamza – Ministër i Financave, Salvador Elmazi – Drejtor i Departmanetit të Buxhetit në MF, Milaim Aliu - Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit Qendror në MF, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit.

Pjesëmarrësit tjerë: Vatra Qehaja nga GPLVV, Naim Jakaj nga GP PSD, Shefki Kastrati nga NDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari: theksoi se Kryesia e Kuvendit në seancën plenare të cakuar me datë 30.01.2019, ka radhitur për shqyrtim edhe katër Projektligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si : Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG për projektin e Ndërtimit të Sistemit të Furnizimit me Ujë të pijshëm për komunën e Ferizajt, Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG si huadhënës lidhur me financimin e projektit ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë për komunën e Graçanicës, Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut dhe Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit

Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes. Meqë si komision funksional jemi ngarkuar ti shqyrtojnë këto projektligje, propozojë që ti shqyrtojmë në mbledhjen e sotme.

Kryetari: Konstatoi se komisioni unanimitisht, vendosi që të plotësohet rendi i ditës, me katër pika të reja: si : Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG për projektin e Ndërtimit të Sistemit të Furnizimit me Ujë të pijshëm për komunën e Ferizajt, Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG si huadhënës lidhur me financimin e projektit ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë për komunën e Graçanicës, Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut dhe Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes.

Bedri Hamza: Theksoi se marrëveshjet në fjalë janë të ngjashme me marrëveshjen paraprake e cila është aprovuar për Komunën e Podujevës, që ka të bëjë me furnizimin me ujë për komunat e Kosovës, si në komunën e Ferizajt, Shtimes, Istogut dhe Graçanicës. Besoj që është kryer një punë e mirë, ka pasur vështirësi në fillim sepse realisht ka qenë marrëveshja e parë bilaterale në mes dy vendeve Austrisë dhe Kosovës dhe ka pasur mungesë të njohurive rreth procedimit të marrëveshjeve, dhe gjithçka është vendosur në kornizë ligjore, në procedurë për futjen e ligjit dhe unë besoj se kjo është një ndihmë e madhe për komunat por edhe për qytetarët e këtyre komunave prandaj unë ju lutem që ti votoni dhe t'i rekomandoni për seancë.

Kryetari: Theksoi se janë marrëveshje me 0% interes dhe janë financime afatgjate në dobi të projekteve kapitale në të gjitha komunat si komision besoj që i mbështesim pa ndonjë hezitim.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht, për Kuvendin nxori këto rekomandime:

1. Të miratohet Projektligji nr.06/L-141 për ratifikimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG, për Projektin për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për Komunën e Ferizajt, me amendamentin si vijon:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit, ndryshohet me tekstin si vijon:

“ Ligj për ratifikimin e Marrëveshjes kreditore në mes Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG”.

2. Të miratohet Projektligji nr.06/L-143 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës, lidhur me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë për Komunën e Graçanicës, me amendamentin si vijon:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit, ndryshohet me tekstin si vijon:

“Ligj për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës, si huamarrës dhe Unicredit Bank Austria AG, si huadhënës, lidhur me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit të ujësjellësit për Komunën e Graçanicës”.

3. Të miratohet Projektligji nr.06/L-144 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, në lidhje me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për Komunën e Istogut.
4. Të miratohet Projektligji nr.06/L-142 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, në lidhje me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për Komunën e Shtimes.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

Kryetari: Ju e keni marrë amendamentet e dy grupeve punuese, me qenë se të gjitha amendamentet janë votuar në grupe punuese dhe komision do ti votojmë si pako, por para votimit janë disa çështje që duhet ti shqyrtojmë tani në Komision. E para amendamenti 3 ka të bëjë me komunën e Ferizajit, ne i kemi bërë disa transfere prej projekteve të Komunës së Ferizajit. Ministria e Financave ka kërkuar që këto shuma të mos ndryshohen të mbesin dhe projektet e reja të financohen nga projektet tjera, dhe propozimi është që të fshihen pikat 1.37 dhe 1.39 nga amendamenti 3.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri vendosi që të hiqet 1.37 dhe 1.39 të amendamentit 3.

Amendamenti 123 i propozuar nga Driton Çausi, ne e kemi përkrahur edhe projektin e deputetit Çausi por kemi thënë që shkurtime të bëhen brenda MASHT-it, dhe MF-i ka thënë që të mos preken këto projekte sepse është e pamundur të bëhen këto ndryshime brenda buxhetit të MASHT-it.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri vendosi që të përkrah amendamentin e deputetit Driton Çausi, me tekstin si vijon:

- “Në Organizatën Buxhetore – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me kod organizativ 208, nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri “Shpenzimet bazike për Qendrat Mësimore”, në shumë prej 500,000 euro.”

Kryetari: Amendamentin 140 nuk e kemi përkrahur. Unë isha në onkologji gjatë javës ata kanë aparatura të vjetra e cila ka trajtimin e 600 pacientëve në fazën finale të jetës, aparatura është prishur. Dhe në qoftë se bëhet fjalë për zgjatje të jetës së disa njerëzve për një vit këtu është problemi. Aparatura kushton 1 milion e gjysmë euro, ne i kemi siguruar 700 mijë euro për shtim të objektit dhe drejtori i onkologjisë tha: që ska nevojë për shtim të objektit por ka nevojë për aparatura. Mendojë që më mirë do të ishte që parat e siguruar për shtim të objektit ti anulohet dhe këtyre parave t’ia gjejmë edhe 700 mijë euro tjera për aparaturë që pacientët të mos shkojnë në Shkup e në vende tjera.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri vendosi që të përkrah amendamentin e propozuar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me tekstin si vijon:

- Në Organizatën Buxhetore “Shërbimi Spitalor, Klinik Universitar i Kosovës” me kod 220 bëhet ndryshimi si ne vijim: Në nënprogrami “Shërbimet terciare shëndetësore në QKUK, me kod 70100, në tabelën 3.2. shtohet projekti i ri “Blerje e aparatit për radioterapi LINAC+, dy bunker + aksesori në Klinikën e Onkologjisë, në shumë prej 1,500,000 euro, prej tyre, 185,162 euro prej burimit të financimit “Të hyrat nga AKP”.

Amendamentet 92-104 janë amendamente në të cilat janë propozuar shkurtime nga Ministria e Financave, për të mbuluar ndarjet buxhetore që ka propozuar komisioni.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri miratoi amendamentet 92-104.

Kryetari: I kemi edhe 5 amendamente të tjera që janë propozuar nga Komisioni për Legjislacion dhe një amendament të propozuar nga deputetja Albulena Balaj-Halimaj, nuk i kemi shqyrtuar fare, pasi që janë proceduar pasi që komisioni ka përfunduar punën, por që janë brenda afatit ligjor.

Bedri Hamza: Sa i përket amendamentit 142 është rritur shumë numri i koeficientit por gjithsesi këta po i kërkojnë 58.600 euro për kategorinë e pagave me mëditje dhe po i kërkojnë gjithsej 7 pozita shtesë dhe për këtë pjesën e gjykatave e ka shqyrtuar edhe komisioni. Unë kisha propozuar të shkojmë me 50% të shumës. Si dhe të përkrahim amendamentin që ka të bëjë me Agjencinë kundër Korrupsionit

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri përkrahu plotësisht amendamentin e propozuar nga Komisioni për Legjislacion për Agjencinë kundër Korrupsionit. Si dhe për përkrahu pjesërisht amendamentin e Komisionit për Legjislacion që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për Gjykatat, me tekstin si në vijim:

“1. Në Organizatën Buxhetore “Këshilli Gjyqësor i Kosovës”, me kod organizativ 328, bëhen ndryshimet me tekstin si në vijim:

- 1.1. Nënprogrami „Sekretariati i KGJK-së”, me kod 33300, në tabelën 3.1., numri i të punësuarve nga 106 ndryshohet në 124.
- 1.2. Nënprogrami, Sekretariati i KGJK-së”, me kod 33300, në tabelën 3.1., në kategorinë “paga dhe mëditje”, shuma prej 1,097,165 euro, burimi i financimit “grantet qeveritare”, ndryshohet në shumën 1,535,427 euro.
- 1.3. Nënprogrami „Sekretariati i KGJK-së”, me kod 33300, në tabelën 3.1., në kategorinë “mallrave dhe shërbimeve”, shuma prej 957, 925 euro, ndryshohet në shumën 1,031,425 euro.
- 1.4. Nënprogrami , Sekretariati i KGJK-së”, me kod 33300, në tabelën 3.1., në kategorinë “shpenzime komunale”, shuma prej 49,700 euro, ndryshohet në shumën 63,200 euro.
- 1.5. Nënprogrami, Sekretariati i KGJK-së”, me kod 33300, në tabelën 3.2., në kategorinë “shpenzimeve kapitale”, në projektin me kod 12793 “Furnizimi me kompjuter, server, fotokopje dhe paisje tjera të teknologjisë informative”, shuma prej 60,000 euro, ndryshohet në shumën 70,000 euro.”

Ndërsa, tre amendamentet tjera të propozuara nga Komisioni për Legjislacion nuk përkrahen. Po ashtu nuk përkrahet as amendamenti i Albulena Balaj-Halimi

Kryetari: Ne kemi vendosur që të ndajmë buxhet për pesë anëtar të Komisionit për Ndihmë Shtetërore dhe e kemi pasur diskutime për vendosjen e tyre në Kuvend apo në Ministrinë e Financave. Për të dhënë sqarime është ftuar Sekretari i Kuvendit.

Ismet Krasniqi: Theksoi se kur janë caktuar pagat e Komisionit për Ndihmë Shtetërore në Kuvend është menduar që për vitin 2018 të paguhen nga buxheti i Kuvendit, mirëpo anëtarët e këtij komisioni

ende nuk janë emëruar. Nëse futen në Kuvend është problem për ne si administratë kategorizimi i tyre në staf politik apo administrativ.

Kryetari: A ka praktika tjera në komisionet tjera të ngashme?

Ismet Krasniqi: Praktika tjera jo, është hera e parë.

Bedri Hamza: Komisioni për Ndhimë Shtetërore është i ri ashtu dhe që po kërkon çdo herë e më shumë rëndësi, duke pasur për bazë që proceset në integrimet evropiane që kërkojnë funksionalizimin e tij. Departamenti për Ndhimën Shtetërore është në Ministrinë e Financave dhe ndërsa nëse vendoset edhe ky Komision në Ministri të Financave atëherë konsiderohet si një llojë konflikt interesi, andaj kjo është arsyeja pse kanë kërkuar me qenë në Kuvend. Nuk është problem financimi i tyre.

Ismet Krasniqi: Esenca është që nëse futen në staf të Kuvendit, është problem kategorizimi i tyre në koeficient, tek cili koeficient të numërohen. E dyta, nëse është nën ombrellën e shërbimit civil, atëherë i takon përgjegjësia Sekretarit të Kuvendit, që në bazë të ligjit përkatës për ndihmë shtetërore nuk i takon.

Kryetari: Komisioni duhet të funksionojë si trup i pavarur nga qeveria dhe nuk mundet të vendoset brenda ministrisë.

Naser Osmani: Ata duhet ti emërojmë agjension i pavarur, që i jep llogari dhe raporton Kuvendit. Ku i bëjnë zyret është çështje tjetër, ata vetëm nuk mundën me qenë në ndërtesë të qeverisë.

Bedri Hamza: Mendoj të bëjmë një nën-program të ri në kuadër të Kuvendit me titull “Komisioni për ndihmë shtetërore”, pasi që i raportojnë kuvendit.

Kryetari: Ne e kemi çështjen që jemi duke u marrur me një institucion nga zeroja, nuk e kemi këtë përvojë dhe nuk e dimë si funksionon në vendet tjera. Propozimi i ministrit më duket më i përshtatshëm, mendoj të bëjmë një nënprogram brenda Kuvendit. I shohim praktikën dhe mund të ndryshojmë në vitet tjera.

- Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri përkrahu propozimin që programi dhe nën-programi i ri “Komisioni i Ndhimës Shtetërore” dhe 5 pozita të reja si dhe buxheti në kategorinë e shpenzimeve “paga dhe mëditje” në shumë prej 63,852 euro, nga amendamenti i Ministrin e Financave, transferohet në buxhetin e Kuvendit, me tekstin si vijon: Në Organizatën buxhetore “Kuvendi i Kosovës”, me kod organizativ 101, në tabelën 3.2. bëhen ndryshimet si në vijim: “Në tabelën 3.1. shtohet programi dhe nën-programi i ri “Komisioni i Ndhimës Shtetërore” dhe 5 pozita të reja. Si dhe shtohet buxheti në kategorinë e shpenzimeve “paga dhe mëditje” në shumë prej 63,852 euro.”

Safete Hadergjona: Faqe 9, amendamenti 8, në pikën 1.17 është bërë një gabim teknik. Vendimi i Komisioni ka qenë që shuma prej 100,000 euro të jetë për vitin 2019 dhe jo siç është prezantuar nga 50,000 euro në dy vite. Çështja dytë ka të bëjë me amendamentin e deputetes Gjevahire Izaku, propozimi i deputetës ka qenë që ndërtimi i objektit kolektiv banesor për familjet e dëshmorëve të UCK-së në komunën e Vushtrisë. Ne e kemi ndryshuar e kemi bërë banim social në prioritet për familjet e dëshmorëve që nuk e kanë zgjidhur çështjen e banimit. Ajo ka thënë që projekti është i tillë në komunë, prandaj ta bëjmë emrin siç ka propozuar deputetja, ndërsa shuma të mbesin siç ka rekomanduar komisioni. Po ashtu propozojë që ta përkrahim amendamentin e dytë të grave deputete, ngase është një kërkesë për një mikroskop të rëndësishëm për analiza të sëmundjes së kancerit.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, miratoi ndryshimet me tekstin si në vijim:

Në amendamentin 8, pika 1.17, ndryshohet me tekstin si vijon:

- “Nën programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore” me kod 60800 në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri “Pastrimi i lumit në fshatin Prilep” në shumë 50,000 euro për vitin 2019 dhe në vitin 2020 shtohet shuma prej 50,000 euro”

Amendamenti i deputetes Xhevahire Izmaku, përkrahet tekstin si vijon:

- “Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”, me kod organizativ 209, në nën-programi “Skema e Asistences Sociale”, me kod 00500, në tabelën 3.2., te shtohet projekti i ri me titull “Ndërtimi i Objektivit kolektiv banesor për familjet e dëshmoreve te Ushtrisë Çlirimtare te Kosovës ne komunën e Vushtrisë “, me shumet si në vijim: për vitin 2019 ne shume prej 450,000.00 euro, për vitin 2020 ne shume prej 400,000.00 euro dhe vitin 2021 ne shume prej 300,000.00 euro!”

Amendamenti i grave deputete përkrahet me tekstin si vijon:

- “Në Organizatën Buxhetore “Shërbimi Spitalor, Klinik Universitar i Kosovës” me kod 220 bëhet ndryshimi si ne vijim: Në nënprogrami “QKUK-Sherbimi Terciare Shëndetsore, me kod 70100, në tabelën 3.2. shtohet projekti i ri, “Blerja e aparaturave në Institutin e Anatomisë Patologjike për të ofruar shërbimet e diagnostifikimittë sëmundjeve malinje”, në shumë prej 201,700 euro.”

Blerim Kuçi: Lidhur me amendamentin e deputetit Ahmet Isufi, që ka të bëjë me ndryshimin e emërimit të projektit në “Rregullimi i rrugëve në Malësin e Kamenicës-Asfaltimi i rrugës Feriqev-Gjyryshevc”, ne kemi thënë që për vitin 2019 mbetet shuma siç është në buxhet, ndërsa për vitin 2020 shtohet shuma prej 200,000 euro dhe për vitin 2021 shtohet shuma prej 300,000 euro. P

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, përkrahu amendamentin e deputetit Ahmet Isufi, me tekstin si në vijim:

- “Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Infrastrukturës” me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet me tekstin si në vijim: Nën-programi “Projektet e Bashkfinancimit me Kuvendet Komunale”, me kod 42000, në tabelën 3.2., emërtimi i projektit me kod 18391, “Rregullimi i rrugëve në Malësinë e Kamenicës, Asfaltimi rruges Feriqev-Gjyryshevcë, Rruga e Sfirçës, Rruga në Fshatin Lisock-Zhuj-Shahiq, Rruga Gmicë-Gjyrishec-Lisock, Rruga Poliçk, Rruga”, ndryshohet me emërtimin “Rregullimi i rrugëve në Malësin e Kamenicës-Asfaltimi i rrugës Feriqev-Gjyryshevc” në shumë prej 418,766 euro për vitin 2019, për vitin 2020 shtohet shuma prej 200,000 euro dhe për vitin 2021 shtohet shuma prej 300,000 euro.”

Enver Hoti: Theksoi se komisioni ka miratuar një kërkesë nga MASHT, për rregullime të brendshme por që nuk është prezantuar në raport, pasi që administrata e komisionit dhe ministrisë së financave, kanë kërkuar sqarime shpesh nga MASHT-i lidhur me kërkesën dhe ata e kanë sjellur dhe kemi të bëjmë me rregullime të brendshme. Çështje tjetër ka të bëjë amendamentin që kam propozuar që në MTI, për departamentin e turizmit të shtohet buxhet.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, miratoi ndryshimet me tekstin si në vijim:

- Përkrahet amendamenti i deputetit Enver Hoti, me tekstin si vijon: “Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Tregtisë dhe Industrisë”, me kod organizativ 204, bëhen ndryshimet si në vijim: Nënprogrami “Departamenti i Industrisë”, me kod 41000, në tabelën 3.1., në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime, shuma prej 57,282 euro ndryshohet në shumën 257,282 euro (për përkrahjen e sektorit të turizmit në Kosovë).

- 1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri “Ndertimi i shkollës fillore në Dragobil – Malishevë” në vitin 2019 në vlerë prej 200,000 euro burimi i financimit ‘Të hyrat nga AKP’, në vitin 2020 në vlerë 200,000 euro dhe në vitin 2021 në vlerë prej 850,000 euro.
 - 1.2. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri “Ndertimi i shkollës fillore në Junik-Deçan” në vitin 2019 në vlerë prej 200,000 euro burimi i financimit ‘Të hyrat nga AKP’, në vitin 2020 në vlerë prej 150,000 euro dhe në vitin 2021 në vlerë prej 750,000 euro.
 - 1.3. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri “Ndertimi i shkolles fillore ne Doberdelan-Suharekë” në vitin 2019 në vlerë prej 200,000 euro burimi i financimit ‘Të hyrat nga AKP’, në vitin 2020 në vlerë 150,000 euro dhe në vitin 2021 në vlerë prej 500,000 euro.
 - 1.4. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri “Ndertimi i Qerdhes në Suharekë” në vitin 2019 në vlerë prej 100,000 euro burimi i financimit ‘Të hyrat nga AKP’, në vitin 2020 në vlerë 100,000 euro dhe në vitin 2021 në vlerë prej 300,000 euro.
 - 1.5. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., të Projekt me kod 18327 “Ndërtimi i shkollës fillore në Gurbardh – Malishevë”, shuma prej 200,000euro në vitin 2019, ndryshohet në shumën 00,000 euro, shuma prej 400,000 per vitin 2020 ndryshohet në shumën 00,00 si dhe 500,000.00 për vitin 2021 ndryshohet në shumën 00,00€.
 - 1.6. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 18326 “Ndërtimi i objektit shkollor në Doganaj Kaçanik”, shuma prej 200,000 euro ndryshohet në shumën 150,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP.”
 - 1.7. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18328 “Ndërtimi i salles së ed.fizike të shkolles në Irzniq, Deçan”, shuma prej 250,000 euro ndryshohet në shumën 200,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
 - 1.8. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 18329 “Ndertimi i sallës së sporteve ne Shalë, Lipjan”, shuma prej 250,000 euro ndryshohet në shumën 200,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
 - 1.9. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18330 “Ndertimi i sallës së ed.fizike të sh.f. në Arllat”, shuma prej

250,000 euro ndryshohet në shumën 200,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.

- 1.10. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 18331 “Ndërtimi i sallës së ed.fizike - sh.f.m.u."Haxhi Hoti" ne Rogovë, Gjakovë”, shuma prej 250,000 euro ndryshohet në shumën 200,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
- 1.11. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18338 “Mbikqyrja profesionale e projekteve kapitale”, shuma prej 200,000 euro ndryshohet në shumën 150,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
- 1.12. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 18035 “Përmirësimi i infrastrukturës në sh.f. "Motrat Qiriazhi" dhe "Avdyl Frasheri" ne Prizren “, shuma prej 200,000 euro, ndryshohet në shumën 150,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
- 1.13. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18029 “Ndërtimi i sallës së ed.fizike te sh.f. "Ibrahim Fehmiu" ne Prizren”, shuma prej 200,000 euro, ndryshohet në shumën 150,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
- 1.14. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 15538 “Ndërtimi i shkollën fillore në Vraniq, Suharekë" ne Prizren”, shuma prej 200,000 euro, ndryshohet në shumën 150,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
- 1.15. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 18340 “Blerja e pakove te pajisjeve te nevojshme per fushat lendore dhe mirembajtje" ne Prizren”, shuma prej 200,000 euro, ndryshohet në shumën 150,000 euro burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”.
- 1.16. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 15262 “Ndertimi i objekteve për institucionet e nivelit parashkollor”, shuma prej 1,100,000 euro në vitin 2021, ndryshohet në shumën 950,000 euro.
- 1.17. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18039 “Ndertimi i shkollës fillore në Llukac i Bregut”, shuma prej 300,000 euro në vitin 2021, ndryshohet në shumën 50,000 euro.
- 1.18. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekt me kod 18040 “Ndertimi i gjimnazit shkencor në Pejë”, shuma prej 300,000 euro ne vitin 2021, ndryshohet në shumën 100,000 euro.

- 1.19. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 15545 “Ndertimi i shkollës fillore në Livoc i Poshtëm, Gjilan”, shuma prej 300,000 euro ne vitin 2021, ndryshohet në shumën 100,000 euro.
- 1.20. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18038 “Ndërtimi shkollës fillore në Prishtinë”, shuma prej 300,000 euro ne vitin 2021, ndryshohet në shumën 100,000 euro.
- 1.21. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., Projekti me kod 18041 “Ndertimi i shkolles fillore në Pejë”, shuma prej 300,000 euro ne vitin 2021, ndryshohet në shumën 100,000 euro.
- 1.22. Nën-programi “Investimet Kapitale në Arsimin Parauniversitar”, me kod 98100, në tabelën 3.2., projekti me kod 15549 “Blerja dhe pajisja e sallave te ed.fizike me pako sportive” , në vitin 2020 shuma prej 1,235,678 euro ndryshohet 1,035,678 euro në vitin 2021, shuma prej 1,195,485 euro ndryshohet në shumën 495,485 euro.

Kryetari: Ministër kemi marrë një kërkesë nga specialistët, unë prita grupin e specialistëve që po kërkojnë që prej subvencioneve të kalojnë në paga. Unë iu sqarova se nuk mund ti marrin pagat me automatizëm pa kontrata. Kjo kërkon një proces të zhvillimit të konkursit dhe ata mund të mbesim pa paga disa muaj. Ata po ashtu thanë që subvencionet po vonohen dhe nuk po paguhen me kohë.

Atëherë zgjidhje më e mirë që të hapet konkursi dhe që të bëhen me kontrata dhe kur të kryhen këto të vijnë tek ne dhe ne ju japin paratë. Ata po kërkojnë që të paguhen me subvencione pra që rrogat ti marrin me rregull, a ka mundësi që këto subvencione të mos pranohen kur të vijnë tek ju?

Bedri Hamza – Ministria e Financave nuk vonon pagesën e subvencioneve. Kjo është përgjegjësit e organizatave buxhetore që ti përgadisnin dhe procesojnë me kohë.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nuk përkrahu kërkesën e specialistëve.

Dardan Molliqaj: Tek amendamenti 79 që një kërkesë e kryetarit të komunës së Kamenicës e prezantuar nga unë , propozimi është që për vitin 2019 të bëhet shuma 400,000 euro, ndërsa për vitin 2020 shuma të jetë 600,000 euro.

Sa i përket amendamentit 128 që ka të bëjë me ndërtimin e zonës ekonomike të përbashkët me komunës së Kamenicës dhe Ranillugut, është bërë fenomen i kësaj e banorëve nga ajo zonë përmes Kroacisë, Bosnjes e kështu, mendojë që është mirë pas fillimit e këtij projekti.

Çështja e fundit që Komuna e Kamenicës është duke e zvogëluar numrin në administratë përkatësisht në arsim, dhe për mësimdhënësit që dalin në pension dhe nuk është duke hapur vende të reja të punës, dhe kanë kërkuar staf shtesë në komunë për shkak sepse janë përgatitur mjaftueshëm për drejtorin të caktuar për ndihmë dhe pasi që nuk po mundën të barten një staf shtesë prej 20 personave dhe kërkesë do të vjenë 10 minuta me email. Nëse ka zgjidhje do të ishte mirë.

Bedri Hamza: Ne kemi rritur numrin e të punësuarve në komuna. Më përjashtim të Komunës së Prishtinës dhe Fushë Kosovës ku nxënësat janë të koncentruar në këto dy vende, në komuna tjera numri i nxënësve shkon duke u zvogëluar. Në Kamenicë është e vërtetë që numri i arsimtarëve është duke e zvogëluar për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve, në administratë kanë kërkuar pozita shtesë, mendojë se nëse i ndajmë 10 pozita, janë të mjaftueshme.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri përkrahu dy amendamentet e deputetit Dardan Molliqaj, me tekstin si vijon:

- “Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Infrastrukturës” me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet me tekstin si në vijim: Në nën-programin “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i bulevardit të qytetit në Kamenicë”, në shumë prej 400,000 euro për vitin 2019, për vitin 2020 shtohet shuma prej 600,000 euro.”
- Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Tregtisë dhe Industrisë”, me kod organizativ 204, në tabelën 3.2., shtohet Projekti i ri me emër “Ndërtimi i zonës ekonomike të përbashkët në mes të komunës së Kamenicës dhe Ranillugut”, në shumë prej 300,000 euro për vitin 2019, burimi i financimit “të hyrat nga AKP”, dhe për vitin 2020 shtohet shuma prej 200,000 euro.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri përkrahur kërkesën e Deputeti Dardan Molliqaj, për ndryshime në Komunën e Kamencisë me tekstin si vijon:

1. Në Organizatën Buxhetore “**Komuna e Kamenicës**”, në tabelën 4.1., me kod organizativ 653, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Në programin “Zyra e Kryetarit” (160), nën-programi “Zyra e kryetarit” (16029), numri i pozitave nga 23, ndryshohet 29.
 - 1.2. Në programin “Zyra e Kryetarit” (160), nën-programi “Zyra e kryetarit” (16029), kategoria e shpenzimeve “paga dhe mëditjeve” shuma 190,000 euro, ndryshohet në 213,760 euro.
 - 1.3. Në programin “Shërbimet Publike dhe mbrojtja Civile, Emergjencia” (180), nën-programi “Infrastruktura Publike(18189), numri i pozitave nga 17, ndryshohet 19.
 - 1.4. Në programin “Shërbimet Publike dhe mbrojtja Civile, Emergjencia” (180), nën-programi “Infrastruktura Publike(18189), kategoria e shpenzimeve “paga dhe mëditjeve” shuma 105,000 euro, ndryshohet në 112,920 euro.
 - 1.5. Në programin “Planifikimi Urban dhe Mjedisi” (660), nën-programi “Planifikim Urban dhe Inspeksioni” (66450), numri i pozitave nga 9 ndryshohet 11.
 - 1.6. Në programin “Planifikimi Urban dhe Mjedisi” (660), nën-programi “Planifikim Urban dhe Inspeksioni” (66450), kategoria e shpenzimeve “paga dhe mëditjeve” shuma 67,000 euro, ndryshohet në 74,920 euro.

Kryetari: Theksoi se kemi pranuar disa amendamentet nga Ministria e Financave, në formë të shkruar, të cilat i keni përpara dhe ia kalojë fjalën përfaqësuesve të ministrisë që ti prezantojnë

Milaim Aliu: Amendamenti 5, 6 dhe 7 hiqen nga raporti për arsye se i kemi propozuar amendamentet e reja të cilat janë reformulu. Po ashtu kemi edhe disa amendament të cilat kanë pasur të bëjnë me klauzolën e investimeve ne i kemi reformulu dhe i kemi dërguar projektet nga niveli qendror nëpër komuna, në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit që do të bëhen.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, miratoi propozimet e ministrisë së financave të cilat do të jenë pjesë e raportit të komisionit në formë amendamentesh.

Arbërie Nagavci: Nëse votohet projektligji për pagat me ndryshime ose pa ndryshime si doni që ti merrni paratë?

Bedri Hamza: Unë nuk mundem me paragjyku se cila do të jetë kostoja e këtij ligji pa u miratuar.

Te Ministria e Financave është e paraparë buxheti për iniciativa të reja të cilat mund të vijnë përmes miratimit të legjislacionit.

Mërgim Lushtaku: E kam ngritur edhe më herët, se është mirë të ndahet buxhet për Ministrin e Administratës Publike për pagesën e licencave për sistemin e IT-së, se përndryshe rrezikojnë institucionet të mbesin të interesit.

Kryetari: Theksoi se tani po shqyrtojmë pjesën tekstuale të Projektligjit. Nëse keni diqka mund të propozoni. Përndryshe, është afërsisht 80% i ngjashëm si ai i vitit kaluar.

Naser Osmani: Unë propozoj që meqenëse kemi shumë projekte me amendamente që i kemi bartur në Ministri, të bëjmë një rregullim që i obligojmë ministrinë të lidhin marrëveshje mirëkuptimi me komunat, që komunat ti realizojnë projektet.

Kryetari: A ka pasur këso raste më herët?

Naser Osmani: Është një rregull diku në një ligj të shkruar më herët që lejohet marrëveshja e mirëkuptimit dhe por kjo varet prej vullnetit të Ministrisë, mirëpo me këtë ligj do ti kishim detyruar që për këto projekte të vogëla, ministrinë e linjës të bëjnë marrëveshje mirëkuptimi me komunat për realizimin e këtyre projekteve.

Bedri Hazma: Theksoi se për ndarjet buxhetore që u propozuan në mbledhjen e sotme, ne propozojmë ndryshimin si në vijim:

1. Në tabelën 3.2, shuma prej 140,000,000 euro, burimi i financimit “Të hyrat nga AKP”, ndryshohet në shumën 151,000,000 euro.
2. Në tabelën 3.2.B, shuma prej 120,638,825 euro, “Klauzola e Investimeve, ndryshohet në shumën 122,707,179 euro.

Po ashtu propozojmë që në Ministrinë e Administratës Publike, të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Administratës Publike” me kod organizativ 202, bëhen ndryshimet me tekstin si në vijim:
 - 1.1. Në tabelën 3.2, nën-programin “Agjencia e Shoqërisë së Informacionit”, me kod 12600, projekti me kod 10423 “Projekti E-Qeverisja”, shuma prej 280,000 euro, ndryshohet në shumën 1,166,954 euro, prej të cilave 886,954 euro burimi i financimit “të hyrat nga AKP”.
 - 1.2. Në tabelën 3.2, nën-programin “Agjencia e Shoqërisë së Informacionit”, me kod 12600, projekti me kod 18010 “SIGURIA KIBERNETIKE”, shuma prej 150,000 euro, ndryshohet në shumën 1,150,000 euro, prej të cilave 1,000,000 euro, burimi i financimit “të hyrat nga AKP”.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, miratoi dy propozimet e lartpërmendura të Ministrisë të Financave, që do të propozohen si amendamente të komisionit.

Kryetari: Theksoi se Qeveria ka proceduar në Kuvend, Propozim - Vendimin për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt 2019, të cilin e keni përpara. Si komision funksional jemi ngarkuar që të shqyrtojmë dhe ti rekomandojmë Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në bazë të propozimit, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të autorizojë zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018, në pajtim me nenin 24.1.b dhe 24.2 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin 04/L-116, Ligjin nr.04/L-194, Ligjin nr.05/L-063 dhe Ligjin nr.05/L-007.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisioni

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku